



**ZEMRA**

**PRINDERORE**

*poezi*

## *DUART E NËNËS*

*Lexoj duart e nënës  
Që fytyra ime të ketë vlerë.*

*Gjithçka në vija të holla,  
Ose brazda të thella...*

*Mozaikë hallesh  
Duart e saj prej shenjti:*

*Porte ku vaporët e vuajtjeve  
Ndalen për të kaluar natën.*

*Gjekë Marinaj*

ISBN 978-99956-20-19-6



9 789995 620196

Çmimi 400 lekë

## GJEKË MARINAJ



Ka qenë e djela e fundit e muajit gusht të vitit 1990-të, kur në një cep të gazetës letrare "Drita", një poezi e fare e shkurtër e titulluar "Kujt", tërhoqi vëmendjen e lexuesve të shumtë dhe bëri një bujë të jashtëzakonshme, aq sa tirazhi i madh i gazetës së njohur u përpi brenda ditës.

Marinaj është një figurë komplekse, e rrallë në letërsinë tonë: poet, përkthyes, editor, gazetar, publicist, pedagog. Gjeografia e tij krijuese fillon nga Shkodra, nga Veriu i Shqipërisë dhe vazhdon deri në skajin tjetër të globit, në Dallas të Teksasit, në Jug të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kemi të bëjmë me një emër të dëgjuar në Shqipëri, në Evropë dhe në Amerikë.

## BABAI DHE NËNA

Eh, sa barrë të rënda kanë tërhequr gjer këtu  
Kurrizet e tyre të ikura prapa si harqe shigjetash.  
Dhe prapë qepallat u hapen e mbyllen  
Si kopertina të vjetra librash -  
Ditarë të saktë legjendash.

Fundshekulli u shkrihet si një flok dëbore në pëllëmbë.  
Sikur ligështohet para tyre i vrarë në ndërgjegje...  
Se prindërit e mi prej tij nuk panë asgjë të bukur,  
Përveç shtatë fëmijë, si shtatë ditë jave të kthjellta.

Përpiqen t'i thonë "Rrugë të Mbarë!" me buzëqeshje,  
Sikur i kanë fshirë të gjitha meritë ndaj tij dhe jetës  
Me gomën e tyre të artë prej qëndrese dhe heshtjeje.

## **DUART E NËNËS**

Lexoj duart e nënës  
Që fytyra ime të ketë vlerë.

Gjithçka në vija të holla,  
Ose brazda të thella...

Mozaikë hallesh  
Duart e saj prej shenjti:

Porte ku vaporët e vuajtjeve  
Ndalen për të kaluar natën.

## **NË DITËLINDJEN E NËNËS**

Sapo e pashë në ëndërr nënën.

Si një trëndafil i velur në  
Dorën e një shenjti, me

62 petale të rëna dhe të  
Kalbura mbi tokë. Koka e  
Saj akoma varur në  
Qiellin e një jete me re të  
Zeza që hezitojnë të kthehen  
Në shi. E pastër dhe e qetë si  
Një zonjë, për herë të parë i  
Lejoi sytë e saj që nëpërmes  
Syve të mi të njomin jastëkun  
Tim prej puplash. Prej puplash të  
Ndukura prej pulave të  
Bardha që për të kënaqur dikë  
Janë therë dhe përvëlur  
Në ujë të valë. Si të fle, kur heshtja  
Në dhomë më ngjan se avullon?  
Në njërin vesh më bëhet se  
Dëgjoj krismat e lugëve dhe  
Pirunëve të zonjave më me fat në  
Tavolina, kurse në veshin  
Tjetër më duket se dëgjoj  
Zhurmët e lopatës dhe  
Të tërfurkut të nënës në arë...  
O, e di, e di se burrat nuk  
Qajnë (të paktën kështu më  
Thoshte nëna kur isha i vogël),  
Por më dhimbset në shpirt e shkreta:

Ajo është tepër e re që të vdesë  
E tepër e lodhur që të rrojë.

## HIMN PËR PRINDRIT E MI

Rritja ime është vetëm një avull i ngrohtë  
Në gishtërinjtë e tyre plot kallo  
Njëzet shkopinj me nyje  
Që mbledhur së bashku  
Víglën më hyjnore të dashurisë,  
Kompozojnë për mua.

Unë edhe mund të jem  
Zhurma që nxjerr një fletë gjatë zhubulisjes,  
Hapësira midis dy strofave të një kënge,  
Apo era e freskët që lëshon boja gjatë shkarravitjes.

Por identiteti më i saktë i qenies sime  
Gjithmonë do të gjendet i mbjellë thellë  
Në dheun e mbetur gjatë punës  
Nën thonjtë e gishtave të prindrve.

## MALL PËR NËNËN

E mora gjithësinë në duar  
Të shuaj mallin e nënës,  
Por kjo ndarja e tërbuar  
Qenka dhimbja e dhembjes.

Diku atje larg përtej detit,  
Diku atje lart buzë qiellit,  
Vështrimet e ftohta të hënës  
Gjithnjë venisin sytë e nënës...

Jemi ndarë në këtë botë  
Si substanca të truara malli;  
Dëshirat sa nisën dështojnë  
Kthehen në vdekje për së gjalli.

Tek i ndjek si foshnje ëndrrat,  
Me duf ia shtyp dy polet globit,  
Sepse boshti i tij prej flake  
Rrotullon tokën kot së kotit.

## NËNA E POETIT LUIGJ ÇEKAJ DHA SHPIRT

*(për mua, prindrit e një poeti janë prindrit e të gjithë poetëve)*

Jeta e nënës së poetit,  
U mbyll me më pak fishkëllimë se një ombrellë.

Zemra e saj  
Për herë të parë  
Murmuriti vetëm për vete,  
Sikur po citonte  
Një alfabet të ri  
Për profecitë e së ardhmes,  
Shkruar diku midis  
Botanikës dhe anatomisë së dy gjetheve.

Si një avokateje  
Të mundur në mbrojtjen e të birit,  
Gjaku në duart e saj e humbi finesën;



Pa shkruar asnjë ligj të ri njerëzor në këtë botë  
U ngri si një deltë poetike mbi vdekjen.

E pafaj si vetë parajsja,  
Formoi në fytyrë  
Një helikë të dhembshme buzëqeshje,  
Dhe përfundimisht lëshoi mbi gjoks,  
Si dy fletë të shkëputura Bible,  
Duart e saj të ndershme njëra mbi tjetrën.